

Komisionet e përhershme

Komisionet e përhershme janë organe kolegjiale që kryejnë funksione në fushat që lidhen me:

- kualifikimin shkencor dhe promovimin akademik;
- garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe të programeve të studimit;
- marrëdhëniet me studentët.

Komisionet e përhershme në UGJ organizohen me vendim të SA-së, në nivel institucioni dhe njësie kryesore dhe përbëhen nga jo më pak se pesë anëtarë, ku bënë pjesë dhe një përfaqësues i studentëve, i propozuar nga Këshilli Studentor i Universitetit të Gjirokastrës, me përjashtim të Komisionit për dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” dhe Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik;

Anëtarët e Komisioneve të Përhershme në nivel institucioni vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik me shumicë të thjeshtë votash, për një mandat 2-vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje. Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve. Kur nuk ka të tillë, Rektori thërret zgjedhjet për vendin vakant, i cili do të ushtrojë detyrën për pjesën e mbetur të mandatit;

Komisionet e përhershme të UGJ-së në nivel institucioni janë:

- Komisioni i kualifikimit shkencor dhe promovimit akademik. Përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë nga personeli akademik që i përkasin kategorisë “Profesor” ose/dhe “Lektor”;
- Komisioni i garantimit të standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit. Përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët, 3 (tre) janë anëtarë nga personeli akademik i njësisë kryesore që i përkasin kategorisë “Profesor” ose/dhe “Lektor”, 1 (një) përfaqësues i rektoratit dhe 1 (një) anëtar është përfaqësues i studentëve;
- Komisioni i marrëdhënieve me studentët. Përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 3 (tre) janë anëtarë nga personeli akademik (nga një për secilën njësi kryesore), 1 (një) anëtar përfaqësues i studentëve dhe 1 (një) anëtar përfaqësues nga personeli ndihmësakademik me karakter administrativ;

Komisionet e përhershme gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre marrin vendime me shumicën absolute (50% + 1) të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të tyre.

Anëtarët e komisioneve të përhershme mund të shpërblehen për punën e tyre sipas përcaktimeve në aktet nënligjore.